



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË
KORÇË

VENDIM
Nr 126 Datë 27.11.08

PER

Shtesë fondi në investimin e objektit "Sistemim në Lagjet 1 dhe 2"

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave "Për shtesë fondi në investimin e objektit Sistemim në Lagjet 1 dhe 2", bazuar në ligjin nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32 pika dh, ligjin nr. 9836 dt. 26.11.2007 «Për buxhetin e Shtetit të vitit 2008», Udhëzimin nr.4 dt.17.01.08 i M.F «Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2008», Udhëzimin nr 258 dt. 15.02.2008 i Ministrisë së Brendshme «Për zbatimin e buxhetit të qeverisjes vendore për vitin 2008 », V.K.B nr. 12 dt. 18.03.2008 «Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2008», Ligji nr. 9936 dt. 26.06.2008 «Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë», në ligjin nr. 9643 dt. 20.11.2006 « Për prokurim publik », i ndryshuar, neni 33, pika 5/a si dhe V.K.M. nr. 1 dt. 10.01.2007 « Për rregullat e prokurimit publik » kreu IV, pika 5/a, paragrafi i gjashtë si dhe mbështetur në kompetencat që ka, mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë shtesën e fondit për investimin në objektin « Sistemim në Lagjet 1 dhe 2 ».
2. Ky fond do të përballohet nga fondi i planifikuar i pagave në Buxhetin e Bashkisë 2008 me këtë strukturë buxhetore :

Pakësohet	00	01110	05	Art 6000000	-	1,584,000
Shtohet	00	04530	05	Art 2310000	+	1,584,000

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave, Drejtoria e Financës, Drejtoria Juridike dhe Sektori i Prokurimeve Publike.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari
Raimonda Nase
Raimonda Nase